



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Nr. 13/15 Prot.

Tiranë, më 09 .06.2021

V E N D I M

Nr. 26/1, datë, 09 . 06. 2021

PËR PUSHIMIN E PROCEDIMIT DISIPLINOR

Komisioni i Policisë Gjyqësore pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore materialet e procedimit disiplinor në ngarkim oficerit të policisë gjyqësore Bilbil Makri, dëgjoji pretendimet e tij dhe pasi analizoi çështjen në tërësi,

K O N S T A T O I:

1. Mbi kërkesën e Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Andi Pogaçe, datë 02.04.2021, "Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore të Shërbimit të Policisë Gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Mallakastër Bilbil Makri", protokolluar në Komisionin e Policisë Gjyqësore, me numër protokollit 13, datë 09.04.2021, Komisioni i Policisë Gjyqësore, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 36, pika 1 e ligjit nr.25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", ka nxjerrë Urdhërin nr.26, datë 07.05.2021 "Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Mallakastër Bilbil Makri, për kryerjen e shkeljeve disiplinore, të parashikuara nga neni 33/3, gërma "d" dhe 33/4, gërma "ç" e ligjit nr.25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore".

2. Nga përmbajtja e kërkesës së Prokurorit Andi Pogaçe dhe Relacioni shoqërues, rezulton se si bazë për kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor kanë shërbyer veprimet dhe mosveprimet, në shkelje të kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore të Shërbimit të Policisë Gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Mallakastër, Bilbil Makri, gjatë kryerjes së veprimeve të para hetimore në kuadër të procedimit penal nr.851, regjistruar në datën 03.08.2020, në ngarkim të shtetasve Shpëtim Sinaj dhe Laver Sinaj, për veprën penale "Kultivimi i bimëve narkotike", parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal.

Nga aktet që u administruan gjatë seancës dëgjimore për procedimin disiplinor, rezulton se:

4.2 Komisioni për rastin konkret, konstaton se pavarësisht ekzistencës së shkeljes disiplinore të parashikuar si e tillë nga ligji 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, ndaj subjektit që e ka kryer atë, nuk mund të aplikojë masa disiplinore, për shkak të kufizimeve që vetë ligji 25/2019 ka vendosur lidhur me afatet kohore për fillimin e procedimit disiplinor dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj oficerëve të Policisë Gjyqësore.

Ligji 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, në nenin 35, pika 1 parashikon se “*Procedimi disiplinor fillon brenda 6 muajve nga zbulimi i shkeljes, por jo më vonë se 3 vjet nga kryerja e saj*”.

Referuar përmbajtjes së kësaj dispozite ligjore, konstatohet se ligjvënësi e ka lidhur procedimin disiplinor të oficerëve të Policisë Gjyqësore, me respektimin e afateve prekluzive, brenda të cilave duhet të merret nisma për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerëve të Policisë Gjyqësore. Mosrespektimi qoftë dhe njërit prej këtyre afateve, sjellë automatikisht mosfillimin apo ndërprerjen e çdo procedure disiplinore ndaj oficerit të policisë gjyqësore, pavarësisht shkeljeve disiplinore që ai ka kryer.

Sikurse rezultojnë nga tërësia e materialeve të administruara gjatë shqyrtimit të procedimit disiplinor dhe nga aktet e procedimit penal nr.851/2020, kërkesa e Prokurorit Andi Pogaçe “Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore, Bilbil Makri është paraqitur tej fatit 6 mujor, të parashikuar nga neni 35, pika 1 e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Nga aktet e procedimit penal nr.851/2020, rezultojnë se materialet hetimore të kryera dhe aktet e përpiluara për dokumentimin e veprimeve të para hetimore, janë referuar nga Komisariati i Policisë Mallakastër, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier me shkresën nr.1534, datë 02.08.2020. Materiali referues është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier në datën **03.08.2020**, me numër protokollit nr.5913 dhe numër kallëzimit 1040, datë 03.08.2020. Po në këtë datë, materiali i ka kaluar për ndjekje prokurorit Andi Pogaçe, i cili, ka nxjerrë Urdhërin, datë **03.08.2020** “Për rregjistrimin e veprës penale”, nëpërmjet të cilit urdhëron Zyrën e Regjistrimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, të regjistrojë procedimin penal për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, i kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal.

Nga përmbajtja e informacionit për referimin e veprës penale në prokurori, (pjesë e materialit hetimor të referuar në prokurori, që oficeri i policisë gjyqësore Bilbil Makri ka hartuar), informon prokurorinë se, në vijim të veprimeve paraprake hetimore është punuar dhe me metodat e teknikës speciale për të provuar e dokumentuar këtë ngjarje, por nga ky veprim nuk është marrë ndonjë e dhënë me interes për hetimin.

Nga sa u parashtrua më sipër, por dhe nga vetë përmbajtja e relacionit shoqëruar të kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor, rezultojnë se prokurori Andi Pogaçe ka ardhur në dijeni të shkeljes disiplinore të kryer nga oficeri i policisë gjyqësore Bilbil Makri që në datën **03.08.2020**. Ndërsa kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore Bilbil Makri, drejtuar Komisionit të Policisë Gjyqësore mbanë datën **02.04.2021** dhe është regjistruar në Komision me numër protokollit 13, datë **09.04.2021**. Referuar këtyre të dhënave, Komisioni konstaton se kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të

1. Pushimin e procedimit disiplinor ndaj Oficerit të Policisë Gjqësore Bilbil Makri, me detyrë, ish oficerë i Policisë Gjqësore të Komisarariatit Mallakastër dhe aktualisht në të njëjtën detyrë në Komisariatin e Policisë Gjirokastrë.
2. Me këtë vendim, të njihet oficeri i policisë gjyqësore Bilbil Makri.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Andi Pogaçe.

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

KRYETARI

ALFRED PROGONATI



ANËTAR

ARJAN MUÇA

ANËTAR

HARI GOGO

ANËTAR

ARTUR SEJATI

Mungon

ANËTAR

ALBERT MUÇO